Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktiviteteve të kompanisë dhe menaxhimi i pozicioneve. Përfshinë edhe rrezikun e të mos qënit në gjendje për të financuar pasurinë me maturitet dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të mos qënit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore me qëllim që të menaxhojë obligimet e saj kur ato vijnë për t'u përmbushur. Maturiteti kontraktual i instrumenteve financiare të kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2024 është si në vijim:

**Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)**

***(ii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)***

| **31 dhjetor 2023** | **Më pak se një muaj** | **1 deri në 12 muaj** | **1 deri në 5 vjet** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | |
| Paraja në dorë dhe në bankë | 2,562,882 | - | - | 2,562,882 |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera | 12,478,178 | - | - | 12,478,178 |
| **Gjithsej pasuritë** | **15,041,060** | **-** | **-** | **15,041,060** |
| **Detyrimet** | | | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 3,564 | - | - | 3,564 |
| **Gjithsej detyrimet** | **3,564** | **-** | **-** | **3,564** |
| **Pozita e likuiditetit** | **15,037,496** | **-** | **-** | **15,037,496** |
| **Hendeku i likuiditetit** | **15,037,496** | **15,037,496** | **15,037,496** | |

| **31 dhjetor 2024** | **Më pak se një muaj** | **1 deri në 12 muaj** | **1 deri në 5 vjet** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | |
| Paraja në dorë dhe në bankë | 1,402,831 | - | - | 1,402,831 |
| Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera | 12,787,284 | - | - | 12,787,284 |
| **Gjithsej pasuritë** | **14,190,116** | **-** | **-** | **14,190,116** |
| **Detyrimet** | | | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 116,024 | - | - | 116,024 |
| **Gjithsej detyrimet** | **116,024** | **-** | **-** | **116,024** |
| **Pozita e likuiditetit** | **14,074,092** | **-** | **-** | **14,074,092** |
| **Hendeku i likuiditetit** | **14,074,092** | **14,074,092** | **14,074,092** | |

***(iii) Rreziku i tregut***

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi i çmimeve të tregut: si kursi i këmbimit të valutave, norma e interesit apo çmimi i aksioneve do të ndikojë në të hyrat dhe instrumentet financiare të mbajtura nga kompania. Objektiva e menaxhimit të rrezikut është që të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, dhe duke optimizuar kthimet.

**Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)**

**(iii)** ***Rreziku i tregut (vazhdim)***

### *Rreziku i valutave të huaja*

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

***Rreziku i normës së interesit***

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Instrumentet financiare të kompanisë që bartin interes janë kreditë. Instrumentet në posedim të kompanisë janë me norma fikse të interesit andaj kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

**Ngjarjet pas datës raportuese**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat e veçanta financiare.

## ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar
Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2021):

- Ndryshimet në fazën e dytë të reformës në Librin e Regjistrimeve të Investimeve (IBOR)

Më 27 Gusht 2020, BSNK lëshoi 'Reformën e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) me ndryshime që adresojnë çështje që mund të ndikojnë në raportimin financiar pas reformës se një pike referimi të normës së interesit, duke përfshirë zëvendësimin e saj me pike referimi të normës alternative. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas dat datës 1 Janar 2021.

- Ndryshimet në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit - një përjashtim i përkohshëm opsional nga zbatimi i SNRF 9 për njësitë ekonomike veprimtaria mbizotëruese e të cilave është lëshimi i kontratave brenda objektit të SNRF 4.

- Ndryshimet në SNRF 16

Më 31 Mars 2021, BSNK publikoi 'Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (Amendamenti i SNRF 16)' që zgjat, për një vit, ndryshimi i Majit 2020 që u ofron qiramarrësve një përjashtim nga vlerësimi nëse një koncesion i qirasë i lidhur me Covid-19 është një modifikim i qirasë. Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021.

Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive
Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- Cikli vjetor i përmirësimeve 2018-2020

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020'. Deklarata përmban ndryshime në katër Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe

SNK 41 si rezultat i projektit vjetor të BSNK-së për përmirësime. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

Standardi Ndryshimet në standard
SNRF 1 - Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve Filial si adoptues për herë të parë dhe përjashtimi vullnetar në lidhje me dallimet kumulative të përkthimit
SNRF 9 - Instrumentet Financiare Tarifat në testin "10 për qind" për çregjistrimin e detyrimeve financiare.
Shembuj ilustrues të SNRF 16 - Qiratë Stimujt e qirasë
SNK 41 - Agrikultura Tatimi në matjen e vlerës së drejtë

- Ndryshimet në SNK 16 në lidhje me të ardhurat para përdorimit të synuar

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Pronë, Impiant dhe Pajisje - Të ardhura para përdorimit të synuar (Ndryshime në SNK 16)' në lidhje me të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa sillte një aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë i aftë të veprojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

- Ndryshimet në SNK 37 në lidhje me kontratat me kushte rënduese (Onerous Contracts)

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Kontratat me kushte rënduese - Kostoja e Përmbushjes së Kontratës (Ndryshime në SNK 37)' duke ndryshuar standardin në lidhje me kostot që një kompani duhet të përfshijë si koston e përmbushjes së një kontrate kur vlerëson nëse një kontratë është me kushte rënduese. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

- Ndryshimet në SNRF 3 që azhurnojnë një referencë në Kornizën Konceptuale

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Referencën në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)' me ndryshimet në SNRF 3 'Kombinimet e Biznesit' që azhurnojnë një referencë të vjetëruar në SNRF 3 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e tij. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

- Ndryshimet në SNK 1 Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata

Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, megjithatë, data e tyre efektive është shtyer në 1 janar 2023.

- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Më 25 Qershor 2020, BSNK lëshoi 'Ndryshime në SNRF 17' për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pasi SNRF 17 'Kontratat e Sigurimit' u publikua në 2017. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2023.

- Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës së SNRF 2

Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi "Shpalosja e Politikave Kontabël" me ndryshime që synojnë të ndihmojnë përgatitësit të vendosin se cilat politika kontabël duhet të shpalosin në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

- Ndryshime në SNK 8 - Vlerësimet Kontabël

Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi 'Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël' për të ndihmuar njësitë ekonomike të bëjnë dallimin midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

- Ndryshimet në SNK 12 – Tatimi i Shtyrë

Më 7 Maj 2021, BSNK publikoi 'Tatimi i Shtyrë në lidhje me Asetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga Një Transaksion i Vetëm' që sqaron se si kompanitë llogarisin tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

# 5. Prokurimi

## 5.1 Puna – Projektet kapitale

| Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 14 | 15 | 19 |
| Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për Nj.O. Deçan, Gurrat e Hasan Agës LOT 2 Furnizimi dhe montimi i pusetave dhe ujëmatësve shtëpiak për fshatrat Poberrgje dhe Hulaj. (Ri-tender IV ) | 21.12.2023. | 22.12.2023. | 7.2.2024. | 6.2.2024. | 55,996.90 | 45,489.00 | Grup i Operatorëve Ekonomik LEMKOS SH.P.K.; " V - SHEHU " SH.P.K. |
| Ndërrimi i gypit në rrugën Vëllezërit Kryeziu ( te stacioni i autobusëve) dhe ndërrimi i gypit në rrugën Bekë Zhuji (Rruga e Rozhajes). | 26.2.2024. | 27.2.2024. | 8.4.2024. | 5.4.2024. | 64,999.12 | 58,395.84 | Grup i Operatorëve Ekonomik VIADUCT GROUP SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K. |
| Ndërrimi i gypit në Vitomericë (Rajoni 2 dhe 3) | 3.4.2024. | 4.4.2024. | 20.5.2024. | 16.5.2024. | 159,989.12 | 149,855.28 | Infra-Plus SH.P.K. |
| Përfundimi - Finalizimi i rezervarëve të Projektit të CDI në njësinë e Klinës | 13.5.2024. | 14.5.2024. | 12.6.2024. | 10.6.2024. | 9,998.85 | 9,968.64 | N.P.SH."HITERM EL" |
| Ndërrimi i ultra filtrave në fabrikën e ujit të pijes në Klinë | 5.4.2024. | 18.4.2024. | 17.6.2024. | 14.6.2024. | 249,151.10 | 246,979.90 | Infra-Plus SH.P.K. |
| Rehabilitim i rrjetit të kanalizimit ekzistues ne njësin e Istogut | 27.5.2024. | 28.5.2024. | 26.6.2024. | 25.6.2024. | 9,996.96 | 6,921.88 | Grup i Operatorëve Ekonomik AL BETON SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K. |
| Ndërimi i gypit në lagjet ku rrjeti është i vjetruar dhe ka humbje të ujit në qutet dhe fshatra të KK. Pejë. LOT 2 Fshatrat të KK Pejës | 13.5.2024. | 15.5.2024. | 26.6.2024. | 25.6.2024. | 69,990.52 | 66,916.62 | V - SHALA SH.P.K. |
| Punimi (vendosja) e rrjetit të ri të ujësjellësit në Vrellë (Ri-tender) | | 13.6.2024. | 22.7.2024. | 19.7.2024. | 15,999.03 | 15,885.16 | " GURI GROUP " SH.P.K. |
| Ndërrimi i gypit AC me gyp PE RC 315mm dhe 160mm në Tikvesh drejtimi të Kishës katolike në Klinë (Ri-tenderII) | | 13.6.2024. | 22.7.2024. | 19.7.2024. | 19,999.82 | 18,305.10 | " GURI GROUP " SH.P.K. |
| Rregullimi i nyjeve për shtimin e kapaciteteve të ujit dhe gypave në pjesën Veriore të Klinës, faza 1 dhe Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit ne lagjet e reja të Klinës. | 11.6.2024. | 12.6.2024. | 29.7.2024. | 25.7.2024. | 59,999.45 | 59,992.38 | " GURI GROUP " SH.P.K. |
| Kalimi i lidhjeve ekzistuese nga AC 250 në PE 315 hapja e pusetave dhe riparimet sipas nevojës në gypat anësor dhe Kalimi i lidhjeve ekzistuese nga AC në PE, nga Sheshi gjakut deri të Shkolla Fillore Bajram Curri. (Ri- tender II) | 12.6.2024. | 13.6.2024. | 29.7.2024. | 25.7.2024. | 37,999.54 | 37,466.18 | " GURI GROUP " SH.P.K. |
| Rehabilitim i pusetës redukuse, ndërrim i gypit primar dhe gypit të tepricës në Blinaja si dhe rehabilitimi i ujësjellësit të lagjes qëndra ka stacioni i autobusëve - JUNUK (Ri-tender) | 12.6.2024. | | 31.7.2024. | 29.7.2024. | 59,986.54 | 49,266.18 | Grup i Operatorëve Ekonomik Eng Bau SH.P.K.; HIDROTERM A SH.P.K. |
| Ndërtimi i rezervuarit dhe stacionit të pompave për sistemin e kanalizimit në fshatrat Poçest, Ramun, Zahaq dhe Gorazhdec të komunës së Pejës. (e ndarë në dy LOT) LOT 2 Ndertimi i rrjetit të kanalizimit me presion. | 7.5.2024. | 10.6.2024. | 30.8.2024. | 23.8.2024. | 239,247.36 | 229,421.50 | Infra-Plus SH.P.K. |
| Ndërimi i gypit në lagjet ku rrjeti është i vjetruar dhe ka humbje të ujit në qutet dhe fshatra të KK. Pejë. LOT 1 Lagjet ne Pejë. (Ri-tender) | 21.6.2024. | 24.6.2024. | 4.9.2024. | 2.9.2024. | 79,996.33 | 77,592.08 | Grup i Operatorëve Ekonomik VALA SH.P.K.; FORTESA SH.P.K. |
| LOT 1 Rehabilitimi i rrethojeve të stacionet të pompimit , rezervuarëve ne Nj.O. Istog | 4.7.2024. | 5.7.2024. | 17.9.2024. | 13.9.2024. | 26,602.16 | 21,675.42 | N.P.N "Npe- Ing" |
| LOT 2 Ndërtimi i rrethojeve tek burimi ne livadhet te madhe dhe tek rezervari ne laxhen Agim Ramadani Nj.O. Junik. | 4.7.2024. | 5.7.2024. | 17.9.2024. | 13.9.2024. | 19,935.00 | 17,324.76 | N.P.N "Npe- Ing" |
| Ndertimi i Depos për materijal ne Nj.O.Pejë | 27.8.2024. | 28.8.2024. | 7.10.2024. | 3.10.2024. | 40,961.34 | 28,921.80 | Grup i Operatorëve Ekonomik HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.; Cubic Group SH.P.K. |
| Ndërrimi i kanalizimit ne rrugën Qerçiz Topulli në Pejë | 1.11.2024. | 12.11.2024. | 16.12.2024. | 13.12.2024. | 9,990.00 | 9,524.96 | BK - CONSTRUCTION SH.P.K. |
| Zhvendosja e tensionit te lart për leshuarje në punë të TRAFOS 100KW në Klinë | 20.11.2024. | 2.12.2024. | 27.12.2024. | 24.12.2024. | 4,993.50 | 3,302.82 | RISAMONT SH.P.K. |
| | | | | | 1,235,832.64 | | |
| Gjithsej kontrata te nenshkruara për | pun projekte Kapitale | | | | | **1,153,205.50** | |

## 5.2 Furnizimet

| Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 14 | 15 | 19 |
| Furnizim me tonera për printera | | 12.12.2023. | 12.1.2024. | 10.1.2024. | 2,906.00 | 1,486.80 | EUROPRINT GROUP SH.P.K. |
| LOT 1 Furnizim më Ujëmatësa Shtepiak. | 23.10.2023. | 25.10.2023. | 15.1.2024. | 12.1.2024. | 68,835.00 | 63,932.40 | Grup i Operatorëve Ekonomik Infra-Plus SH.P.K.; Infra -Group.ks |
| LOT 1 Furnizim me fazoneri DN 50 - DN 600. | 27.12.2023. | 28.12.2023. | 13.2.2024. | 9.2.2024. | 59,979.40 | 59,059.76 | Grup i Operatorëve Ekonomik Infra-Plus SH.P.K.; Infra -Group.ks |
| LOT 2 Furnizim me Klamsa (armatura) | 27.12.2023. | 28.12.2023. | 13.2.2024. | 9.2.2024. | 40,002.12 | 39,998.34 | Grup i Operatorëve Ekonomik Infra-Plus SH.P.K.; Infra -Group.ks |
| Furnizim me pjës për riparim dhe mirëmbajtja - Servisim e pompave - punë Mekanike (Ri-tender II) | 28.12.2023. | 29.12.2023. | 13.2.2024. | 9.2.2024. | 29,962.56 | 29,889.40 | N.P.SH."HITERM EL" |
| Furnizim me kemikate për ITUN për analiza në labarator | | 17.1.2024. | 4.3.2024. | 29.3.2024. | 22,978.00 | 14,014.03 | Vitech Sh.p.k. |
| Furnizim me Vajra Speciale për paisjet në ITUN | | 24.1.2024. | 8.3.2024. | 7.3.2024. | 40,456.30 | 37,462.05 | Orbico SH.P.K. |
| LOT 1 Furnizim me matrial te imet per zyre. | 31.1.2024. | 9.2.2024. | 8.4.2024. | 5.4.2024. | 13,261.00 | 10,278.45 | N.T. "Agimi- De" |
| LOT 2 Furnizim me tonera per printera dhe fotokopje. | 31.1.2024. | 9.2.2024. | 8.4.2024. | 5.4.2024. | 12,049.00 | 5,863.58 | BMS SOLUTIONS L.L.C. |
| LOT 3 Furnizim me fatura dhe blloka te shtypur sipas mostres. | 31.1.2024. | 9.2.2024. | 8.4.2024. | 5.4.2024. | 44,690.00 | 17,965.50 | EUROPRINT GROUP SH.P.K. |
| Furnizim me minitraktor - motokultivator për kositje të barit në ITUN | | 26.3.2024. | 22.4.2024. | 19.4.2024. | 4,956.00 | 4,070.00 | N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k. |
| Furnizim me bombola për bartje të klorit (Ri tender II) | | 29.3.2024. | 1.5.2024. | 29.4.2024. | 7,999.81 | 7,994.03 | Seykos SH.P.K. |
| Furnizim me Ormana metalike (Rack Cabinet) materijal shpenzues si kabllo, konektor adapter. etj. | | 3.4.2024. | 8.5.2024. | 7.5.2024. | 1,994.20 | 1,574.31 | " INFINITT " SH.P.K. |
| . LOT 1 Furnizimi me lidhëse nga PE O 1 2 - O 4 . | 25.4.2024. | 30.5.2024. | 15.7.2024. | 11.7.2024. | 25,700.87 | 25,073.16 | KOSOVA WATER AND ENERGY SH.P.K. |
| LOT 2 Furnizimi me lidhëse metalike O 1 2 - O 4 . | 25.4.2024. | 30.5.2024. | 15.7.2024. | 11.7.2024. | 24,297.38 | 22,794.26 | " Enigma - B B " Sh.p.k. |
| LOT 1 Gypa PE për Kanalizim | | 20.6.2024. | 22.7.2024. | 18.7.2024. | 4,999.66 | 4,570.14 | " Omega - I " SH.P.K |
| LOT 2 Kapak nga GIZ-a për puseta të Kanalizimit | | 20.6.2024. | 22.7.2024. | 18.7.2024. | 5,000.01 | 4,452.75 | HIDROTERM A SH.P.K. |
| Furnizim me Pompa dhe Frekfentor për stacionet të pompave ekzistuëse në Istog | | 17.6.2024. | 31.7.2024. | 29.7.2024. | 20,000.00 | 17,489.97 | Grup i Operatorëve Ekonomik ROA Consulting SH.P.K.; LONCOM SH.P.K. |
| Furnizim me kemikate për analiza laboratorike të ujit | 11.7.2024. | 15.7.2024. | 22.8.2024. | 21.8.2024. | 25,000.00 | 21,547.63 | Flamur Isufi B.I. |
| Furnizim me klor të gazet dhe të lëngët | 25.7.2024. | 26.7.2024. | 14.10.2024. | 10.10.2024. | 160,000.00 | 159,087.60 | Grup i Operatorëve Ekonomik INFINITT SH.P.K.; LIGHT HOUSE; E LOGISTICS L.L.C. |
| Furnizim me Gypa PE të dimensioneve të ndryshme, për mirëmbajtje të rrjetit të furnizimit me ujë | 15.10.2024. | 17.10.2024. | 5.12.2024. | 3.12.2024. | 14,997.80 | 9,773.35 | " Omega - I " SH.P.K |
| Lot1 Furnizim me mjete te punës | 5.11.2024. | 7.11.2024. | 24.12.2024. | 23.12.2024. | 4,993.76 | 4,320.49 | ASDEK SH.P.K. |
| Lot2 Furnizim me pajisje për punë | 5.11.2024. | 7.11.2024. | 24.12.2024. | 23.12.2024. | 5,994.40 | 3,858.00 | ASDEK SH.P.K. |
| | | | | | 641,053.27 | | |
| Gjithsej kontrata te nenshkruara për | Furnizim | | | | | **566,556.00** | |

## 5.3 Shërbimet

**SHERBIMET**

| Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 14 | 15 | 19 |
| Hulumtim mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve | | 1.2.2024. | 26.2.2024. | 23.2.2024. | 2,628.00 | 1,221.30 | D&D Business Support Center L.L.C. |
| Ekspert i jashtëm - Kontabilist i çertifikuar (Ri-tender) | 15.2.2024. | | 28.2.2024. | 27.2.2024. | 990.00 | 850.00 | Bekë Hoxhaj |
| Marrje me qira e paisjeve dhe shërbimeve të GPS për mbikqyrjen monitorimin dhe përcjelljen e automjeteve dhe mjeteve tjera të transportit, gërmimit, bartjes etj. | 15.1.2024. | 17.1.2024. | 6.3.2024. | 5.3.2024. | 20,995.20 | 20,645.28 | TMS MOBILE SH.P.K. |
| Mbushja dhe servisimi i aparateve (bocave) për shuarjen zjarit. | | 23.5.2024. | 20.6.2024. | 18.6.2024. | 5,996.76 | 5,937.29 | PROGLOBAL SH.P.K. |
| Vazhdim i licensave ekzistuese të programit të Antivirus-it (ish-Mcafee e tash)Trellix | | 18.10.2024. | 12.11.2024. | 8.11.2024. | 6,300.00 | 4,480.22 | InterAdria L.L.C. |
| | | | | | 36,909.96 | | |
| Gjithsej kontrata te nenshkruara për Sherbime | | | | | | **33,134.09** | |

| | |
|---|---|
| **Gjithsej Kontrata të nenshkruara për Punë + Furnizim + Sherbime për vitin 2024** | **1,752,895.59** |

Ne tabelen e meposhtme jan prokurimit per te cilet jan publiku Njoftimet per kontrat dhe jan ne procedur

| Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 14 |
| Regullimi - Furnizimi, montimi dhe funksionimi i pajisjeve për klorinim ne te pës Nj.O. LOT 1 Regullimi - Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve për klorinim ne katër Njesi Operacionale: Pejë, Istog, Klinë dhe Junik. | | 13.12.2024 | | | 55000.00 |
| LOT 2 Ndërtim i shtëpizës se klorinimit dhe zëvendësimi i pjesëve ne disa klorinator në Nj.O. Deçan. | | 13.12.2024 | | | 30000.00 |
| Furnizim dhe montim i basket screen-it në piken hyëse te ITUN-it. | | 05.12.2024 | | | 75000.00 |
| Furnizim me material për labarator dhe puna për ndarjen e zyres. | | 20.12.2024 | | | 10000.00 |
| | | | | | |
| Renovimi I zyreve dhe Arkes | | 20.12.2024. | | | 15,000.00 |
| Instalimi I Ujematësave në Nj.O. Deçan dhe Strellc | | 30.12.2024. | | | 100,000.00 |
| | | | | | |
| | | | | | |
| Furnizim dhe montim kamerave dhe Wireless në ITUN | | 30.12.2024. | | | 22,500.00 |
| Furnizim me pajisje për TI Desktop Kompjutera , Monitora , Telefona për lexim mobil për inkasanta. | | 20.12.2024. | | | 32,750.00 |
| Furnizim me Ujëmmatës të ndryshëm | 23.12.2024. | 24.12.2024. | | | 80,000.00 |
| Furnizimi me automjete pune | | 17.12.2024. | | | 150,000.00 |
| Furnizim me softstartera për frekfentor | | 11.12.2024. | | | 30,000.00 |
| Furnizim me pjes per Mirëmbajtja e debllokuesve dhe Bagerave | | 30.12.2024. | | | 15,000.00 |
| Furnizim me pjes per Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve Peugeot dhe Reno, si dhe Kamioneta Mercedes dhe Iveko. | | 30.12.2024. | | | 15,000.00 |
| Furnizim me kemikate (Polimer) për ITUN | | 23.12.2024. | | | 90,000.00 |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| Rregullimi i automjeteve ( Bager dhe Debllokues) | | 11.12.2024. | | | 10,000.00 |
| Marrja me qira e shërbimeve të shtypjes (printimit), fotokopjimit dhe skanimit. | | 24.12.2024. | | | 30,000.00 |
| | | | | | |
| | | | | | |

# 6. Departamenti komercial

## 6.1 RAPORTI I PËRGJITHSHËM

Në raportin e departamentit komercial janë përfshirë indikatorët kryesorë që reflektojnë punën dhe performancën e departamentit për vitin 2024. Ky raport është hartuar mbi të dhënat e sistemit Rikont, si dhe mbi raportet e inspektorëve dhe menaxherëve të njësive. Të dhënat e raportuara nga sistemi Rikont janë për periudhën 1 vjeçare ndërsa të dhënat e raportuara nga inspektoret dhe menaxheret e njësive janë për periudhën gjashtë mujore përkatësisht Korrik-Dhjetor 2024.

**Mirëmbajtja dhe ndërrimi i ujëmatëseve**

Tabela 1. Ujëmatësit e ri , ndërruar, te pastruar dhe te riparuar

| KRU Njësitë | Ndërrimi i ujëmatëseve | Ujëmatës për herë të parë | Prishje në pusetë | Të rregulluara | Shkyçje me kërkesë |
|---|---|---|---|---|---|
| Pejë | 157 | 109 | 374 | 374 | 3 |
| Istog | 76 | 17 | 27 | 27 | 1 |
| Klinë | 31 | 72 | 14 | 14 | 3 |
| Deçan | 100 | 59 | 99 | 99 | 2 |
| Junik | 15 | 13 | 16 | 16 | 0 |
| Totali: | 379 | 270 | 530 | 530 | 9 |

**Konsumatorët e ri për vitin 2024**

1. Konsumator Amviseri - 2102
2. Konsumator Biznese - 218
3. Institucione 12
4. OJQ - 1

Tabela nr.2. Faturimi dhe Arkëtimi

| KRU Njësitë | Nr. i faturave të lëshuara | Sasia e ujit te faturuar (m3) | Sasia e ujit të faturuar (m3) - pa pagesë | Vlera e faturuar në (Euro) | Arkëtuar pa TVSH |
|---|---|---|---|---|---|
| Pejë | 385,026 | 5,688,017 | 190,846 | 2,655,214.98 | 2,465,372.00 |
| Istog | 139,468 | 2,194,829 | 5,644 | 949,495.00 | 779,774.10 |
| Klinë | 71,430 | 698,717 | 610 | 374,386.30 | 360,988.40 |
| Deçan | 86,663 | 1,082,395 | 36,168 | 429,314.20 | 416,534.90 |
| Junik | 19,509 | 322,226 | 88 | 143,805.19 | 122,885.80 |
| Totali: | 702,096 | 9,986,184 | 233,356 | 4,552,215.67 | 4,145,555.00 |

- Arkëtimi nga raporti i inkasanti te kategoria i pacaktuar për vitin 2024 është 2,864.52€ pa TVSH që i shtohet arkëtimit total 4,145,555.00€ të caktuar në raport të Rikontit sipas inkasantit nëpër njësi.

**Raportet e inspektorëve**

Tabela nr.3. Inspektimet e konsumatorëve, legalizimet dhe vërejtjet për borxh

| KRU Njësitë | Inspektime | L.Legalizime | Lidhje jashtë ujëmatësit | Vërejtje para shkyçjes | Shkyçje për borxh |
|---|---|---|---|---|---|
| Pejë | 1526 | 637 | 10 | 331 | 3 |
| Istog | 211 | 133 | 1 | 38 | 1 |
| Klinë | 423 | 99 | 1 | 25 | 0 |
| Deçan | 0 | 0 | 0 | 35 | 0 |
| Junik | 0 | 7 | 0 | 6 | 0 |
| Totali: | 2160 | 876 | 12 | 435 | 4 |

**Shërbimi me konsumatorë**

Tabela nr.4. Kontratat me konsumator, gjendjet e lexuara dhe ankesat

| KRU Njësitë | Kontrata te shërbimit | Kontrata riprogramim borxhi | Ankesa | Gjendje të lexuara |
|---|---|---|---|---|
| Pejë | 711 | 209 | 40 | 132,884 |
| Istog | 654 | 144 | 0 | 20,039 |
| Klinë | 209 | 90 | 0 | 20,485 |
| Deçan | 3 | 33 | 0 | 37,107 |
| Junik | 222 | 16 | 4 | 6612 |
| Totali: | 1799 | 492 | 44 | 217,127 |

- Faturave të konsumatorëve me adresë në banesa të ndara për dërgim me postë; filluar në korrik me 8,275 dhe përfunduar viti 2024 në dhjetor me numër prej 10,314 fatura për dërgim me postë.

# 7. Auditori i brendshëm

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të punës dhe aktiviteteve të Zyrës së Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh.A , për periudhën Janar – Dhjetor 2024. Përmes këtij raporti prezantohet niveli i realizimit të caqeve të përcaktuara me plan vjetor të punës për vitin aktual.

Aktivitetet e auditimit të brendshëm gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm për vitin 2024, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura nga Komisioni i Auditimit.

Objektivat kryesore të auditimeve kanë qenë:

- Rishikimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të dizajnuara nga menaxhmenti;
- Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset janë kryer në pajtueshmëri me ligjet aplikative dhe aktet tjera të brendshme;
- Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset e realizuara janë të një performance të duhur duke përbushur disa nga kriteret në aspektin ekonomik, atë të efikasitetit dhe të efektivitetit;
- Nxjerrja e rekomandimeve praktike për përmirësime aty ku është e nevojshme, si dhe
- Rishikimi i rekomandimeve dhe niveli i përmbushjes apo implementimit të tyre.

Në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi, standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe planit vjetor të punës së auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2024 janë realizuar këto aktivitete:

- Raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2023;
- Plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën kohore trevjeçare 2025 – 2027;

Duhet theksuar se gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 8 auditime. Prej tyre të planifikuara me plan vjetor 2024 kanë qenë 5 auditime, ndërsa 3auditim shtesë është kryer me kërkesë.

Bazuar në planin vjetor të auditimit, si dhe kërkesave të Komisionit të Auditimit fushëveprimi i auditimit ka qenë:

1. Menaxhimi i Njësive Operative;
2. Menaxhimi i prodhimit dhe humbjeve të ujit;
3. Menaxhimi i faturimit dhe inkasimit;
4. Procesi i pagave dhjetor 2023 - janar 2024;
5. Barazimi i arkave dhe bankave Tm1/2024;
6. Auditimi i proceseve;
7. Auditimi i kontratave të pozitave menaxheriale;
8. Barazimi i arkave dhe bankave Tm1/2024;

Duhet theksuar, se gjatë auditimit të disa fushave dhe proceseve, normalisht se janë vërejtur dhe konstatuar disa mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime për tu përmirësuar.

Gjatë rishikimit të adresimeve të rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës audituese vjetore, të paraqitura në vijim të raportit, është konstatuar se nga 28 rekomandimet e dhëna, 8 prej tyre janë zbatuar, 19 janë në proces të zbatimit, ndërsa 1 rekomandim është i pazbatuar.

# 8. Teknologjia informative

## Parathënie

Gjatë vitit 2024, si zyre e TI-së kemi vazhduar të mbështesim infrastrukturën teknologjike, duke siguruar funksionim të vazhdueshëm të sistemeve dhe përmirësim të sigurisë kibernetike, e gjithashtu kemi dhënë mbështetje për personelin dhe përdoruesit në tërë kompaninë.

Si rezultat i ndryshimeve, dhe avancimeve në Kompaninë tonë, në përgjithësi viti 2024 ka qenë mjaft produktiv.

Në vazhdim, në formë të përmbledhur po i përmendim vetëm ato më të rëndësishmet.

### 1.1 Personeli i zyrës së TI-së

Në fillim të muajit Janar, personelit të zyrës së TI-së i është bashkëngjitur edhe një anëtar, kështu tashmë ekipa e jonë përbëhet nga gjithsejtë tre (3) anëtarë. Me këtë, janë krijuar kushtet për një gatishmëri dhe efikasitet edhe më të lartë të zyrës sonë.

### 1.2 Pajisjet, programet (“hardware & software”) e TI-së dhe siguria kibernetike

Si pjesë e planifikimeve tona të mëhershme është realizuar tenderi për furnizim me pajisje të TI-së (HIDRO-23-8832-121/C134) që ka nisur me zbatim nga fundi i vitit 2023. Si rrjedhojë në fillim të vitit 2024 kemi pranuar pjesën e mbetur të furnizimit, pra këto pajisje:

#### 1.2.1 Kompjuterët dhe monitorët

25 kompjuterë dhe 25 monitorë me pajisjet përcjellëse si “tastierë” dhe “mouse”. Këta kompjuterë, i kemi përgatitur sipas procedurave tona dhe i kemi dhënë në shfrytëzim te personeli i jonë. Pra, i kemi bartur shënimet përkatëse, i kemi kryer konfigurimet e nevojshme. Në të njëjtën kohë, i kemi larguar 25 kompjuterë nga përdorimi, të cilët kanë qenë shumë të vjetër, me kapacitete të dobëta, sisteme të vjetra operative e që gjithashtu paraqet potencial për ndonjë “incident” kibernetik.

#### 1.2.2 Pajisjet e rrjetit – “Fortigate”, “Switch”

Si pjesë e tenderit të përmendur mësipër, së bashku me kompjuterët e përmendur mësipër kemi pranuar edhe 2 pajisje të menaxhueshme të rrjetit të quajtura “Fortinet Switch”, të cilat edhe i kemi vënë në funksion, në “dhomën e serverëve”. Këto pajisje janë të një cilësie të lartë dhe posedojnë porte me shpejtësi “Gigabitëshe” e gjithashtu pasi që janë të menaxhueshme, ofrojnë mundësi të segmentimit të rrjetit, filtrimit etj.

#### 1.2.3 Antivirusi – “Trellix”

E kemi pranuar edhe licencën e re për programin mbrojtës të antivirusit “Trellix”. Licenca është e vlefshme për 3 vite për 70 pajisje. Për ta implementuar, e kemi krijuar një server virtual në të cilin e kemi vendosur panelin komandues (“ePolicy Orchestrator On-Premises”) të këtij programi, përmes së cilit dirigjojmë instalimet e mëtejme nëpër pajisjet kompjuterike, aplikimin e rregullave, si dhe mund të monitorojmë gjendjen e kompjuterëve dhe problemet eventuale.

#### 1.2.4 Centrala telefonike

Në centralen telefonike i kemi vendosur 2 numra të ri: njëri është numër fiks i telefonit ndërsa tjetri, mobil (Telekomi dhe Vala). Janë kryer konfigurimet e nevojshme dhe e kemi hartuar një propozim - rregullore të punës për operatorët e centrales. Në të ardhmen, mund të ketë edhe konfigurime shtesë për t’iu përshtatur nevojave tona dhe për ta bërë atë sa më funksionale.

### 1.3 Telefonat mobil

Pas dorëzimit të tyre nga KE, 8 telefona mobil në bashkëpunim me kompaninë Informatika i kemi përgatitur dhe iu kemi dorëzuar departamentit komercial për t’iu dhënë ato personelit në terren për leximet mobile të ujëmatësve.

## 1.4 Web-faqja e kompanisë

Gjatë vitit 2023 kemi pranuar njoftimin për gatishmërinë e mbështetjes nga Sachsen Wasser GMBH për krijimin e një Web-faqeje të re për kompaninë tonë. Si rezultat edhe është nënshkruar një kontratë e shërbimit në Dhjetor 2023 ndërmjet kësaj kompanie, KRU "Hidrodrini" dhe "Postieri" xyz për zhvillimin e web faqes se re.

Kështu, që nga Janari 2024 është bashkëpunuar shumë ngushtë brenda epikes sonë që përbëhej nga KE, Zyrtari për Informim, Menaxheri i zyrës së TI-se me përfaqësuesin e kompanisë postieri për zhvillimin, përmbajtjen dhe dukjen e faqes sonë të re. Pas funksionalizimit të web-faqes së re, e kemi pezulluar web-faqen e vjetër e cila, mbetet akoma aktive sepse i kemi edhe disa shërbime akoma të ndërlidhura, mirëpo nuk është e qasshme në mënyrë të drejtpërdrejt nga interneti.

Në vazhdim po e paraqesim vetëm një pjesë nga web-faqja e re, e gjithashtu potencojmë se web-faqja në mënyrë konstante plotësohet dhe pasurohet me materiale të ndryshme.




Në vazhdim, po i paraqesim disa statistika mbi numrin e vizitorëve në web-faqen e kompanisë sonë.




## 1.5 Pagesat "online" për faturat e shërbimeve të kompanisë sonë

### 1.5.1 Pagesat nga web-faqja

Pas një angazhimi të përbashkët që e kemi pasur (KE, IT) me përfaqësuesit e kompanisë Informatika dhe me përfaqësuesit e bankës BKT, ia kemi arritur që ta realizojmë mundësinë që konsumatorët tonë të paguajnë

faturat e tyre edhe “online” përmes web-faqes sonë. Testimet përfundimtare janë kryer gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2023 derisa publikimi për këtë formë të pagesës është bërë zyrtarisht në muajin janar 2024.

### 1.5.2 Pagesat nga platforma “eKosova”

Pas shumë kërkesave tona dhe si rezultat i angazhimit të përbashkët disamujor ndërmjet nesh (KE, IT) dhe kompanisë Informatika, dhe zyrtarëve dhe bashkëpunëtorëve të platformës “eKosova” më në fund me sukses ia kemi arritur që t’ju ofrojmë konsumatorëve tonë edhe mundësinë që t’i paguajnë faturat për shërbimet e Kompanisë sonë edhe në këtë platformë.

### 1.5.3 Komponenta/aplikacioni mobil, për Android dhe iOS

Kërkesë e vazhdueshme e jona (KE, IT) që i paraqitet kompanisë Informatika është që programi ekzistues Rikont të zgjerohet edhe me komponenten për pajisjet mobile, nga ku konsumatorët do të mund të shihnin faturat e tyre dhe të paguanin për shërbimet e “Hidrodrini”, kjo është premtuar dhe mbesim me shpresë që do të realizohet në fillim të vitit 2025.

## 1.6 Rrjeti “WAN”, “LAN” dhe “Wireless”

### 1.6.1 Rrjeti i jashtëm “WAN”

Pas kërkesave tona të shumta më në fund, përgjatë vitit 2024, Telekomi i Kosovës ka filluar që t’i përmbushë kërkesat tona, kështu në zyrat në: Pejë (të Burma), Junik, Deçan (administrata), si dhe në zyrën e re të Arkës (afër stacionit të Policisë) janë kryer lidhjet për Ofrimin e Shërbimeve të Internetit me teknologjinë “Fije Optike”.

### 1.6.2 Rrjeti i brendshëm “LAN” dhe “Wireless”

Si rezultat i cilësisë së dobët të kabllove apo edhe vjetërsisë së tyre, kemi pasur telashe e në disa pozicione edhe na është dashur që t’i ndërrojmë kabllot, e në disa të tjera brenda objektit të zyrave qendrore e të tjera i kemi shtuar (në mënyrë improvizuese).

Në disa prej zyrave sikurse në ITUN, Burma, Porta, Kati 3 ZQ, dhe Klinë kemi vendosur pajisje për kyçje në internet pa tel.

## 1.7 Sistemet e vëzhgimit me kamera

Ndryshimet në sistemet ekzistuese të kamerave:

- Sistemi ekzistues të kamerave në ITUN, ia kemi shtuar edhe 2 kamera te porta hyrëse.
- Sistemit ekzistues të kamerave në Rezervuar ia kemi shtuar edhe 1 kamerë,
- Në zyrat qendrore i kemi ndërruar 4 kamera (të cilësisë së dobët),
- E kemi instaluar 1 kamerë të pavarur në Zyrën e Junikut,
- E kemi instaluar 1 kamerë të pavarur në Zyrën e Arkës në Vitomericë,
- E kemi instaluar 1 kamerë të pavarur në Zyrën e Arkës te Policia e Trafikut.

## 1.8 Bashkëpunimi me departamentin komercial

Përgjatë vitit kemi vazhduar të mbështesim të gjitha departamentet dhe personelin e kompanisë e në veçanti departamentin komercial.
Secilin muaj kemi shtypur faturat e konsumatorëve, në bashkëpunim të ngushtë me departamentin komercial.

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit e cila është nënshkruar ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe përfaqësuesve të Postës së Kosovës, për shtypjen, zarfimin dhe shpërndarjen e faturave, kemi përgatitur formatin e faturës, i kemi përgatitur faturat në formatin “pdf” dhe i kemi dërguar secilin muaj që nga Korriku 2024.


KRU''HIDRODRINI''SH.A. - PEJË
STRUKTURA ORGANIZIATIVE
2023
Kryeshefi Ekzekutiv Niveli 01
Drejtor Departamenti 02
Menaxher Divizioni 03
Shef i Sektorit 04
Bordi i Drejtorëve
Komiteti i Auditimit
Kryeshefi* Ekzekutiv
Auditori* i Brendshëm
Zyrtari për Rapotim UPF
Zyrtari i Prokurimit
Teknologjia Informative
Zyrtari i Cartifikues*
Departamenti për Administratë [Sekretari*]
Departamenti për Financa [ZLF*]
Departamenti për Shitje dhe Konsumatorë [Drejtori Komercial]
Departamenti Teknik [Drejtori Teknik]
Menaxheri I Administratës dhe B.NJ
Personeli dhe Administrata
Çeshtjet Ligjore
Siguria në Punë
Menaxheri Financiar
Kontabiliteti Material
Kontabiliteti I Aseteve
Planifikimi Raportimi
Depo
Keshi dhe Bankat
Menaxheri Komercial dhe Shërbimi me Konsumatorë
Leximi I Ujëmatësve
Faturimi
Pagesat (arkat)
Menaxhimi I Borxheve
Njësia e Kontrollit
Data baza e të Dhënave
Kërkesat dhe Ankesat
Marrdhëniet me Publikun
Menaxhimi I Ujëmatësve
Shkyçjet
Cilsia e Ujitë dhe Burimet
Mbrojtja e Burimeve
Laboratori
Furnizimi me Ujë të Pijshëm
Mirëmbajtja dhe Operimi I Rrjetit
St. I pompimeve dhe Rezervuaret
Impianti I Ujitë të Pijshëm
Ujërat e Ndotura
Mirëmbajtja dhe Operimi I Kanalizimit
Kullimi I Ujeërave Atmosferik
ITUZ
Mirëmbajtja dhe Operimi I ITUZ
Menaxhimi I Llumit
Laboratori I ITUZ
Planifikimi &Zhvillimi
UPF (DMA)
GIS
Menaxhimi I Aseteve Investimet
Menaxhimi I Projekteve
Menaxheri i Njësisë Peja
Menaxheri i Njësisë Istog
Menaxheri i Njësisë Deçan
Menaxheri i Njësisë Kinë
Menaxheri i Njësisë Junik